REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 22/17
Datë/Datum. 23.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE)*

Për Aktivitetin e Prokurimit *(Nr. i Prokurimit 202-16-317-221 Nr i brendshëm 202-17-002-221)*

Sa i përket tenderit për *(Mirëmbajtja higjenike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësis)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*
Kompania e Pastrimit Laguna sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Rruga:Idriz Gjilani pn,Prishtinë

(Adresa)
Prishtinë — *10 000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
045 900020
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

LORIK AZEMI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
lagunashpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

23.01.2017

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

SHPK LAGUNA

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë në KRPP 11.01.2017

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Ne ishim të pranishum dhe nuk kishe vëretje gjatë hapjes së ofertave më 25.05.2016

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Pas njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit ne kemi bërë kërkesë për rishqyrtim në Ministrin e Administratës publike

Provë:
Kërkesa për rishqyrtim numer protokolli 197/ i datës 18.01.2017 dhe
Vendimi i MAP-it i datës 20.01.2017

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Është shkelur Neni 22
Është shkelur Neni 24
Është shkelur Neni 111

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania Laguna sh.p.k. është e interesuar që të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit të inicuar nga Ministria e Administratë Publike me numer të prokurimit: 202-16-317-221 , me numer të brendshëm: 202-17-002-221 dhe me titull: Mirëmbajtja higjenike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësis. **Ne vlerësomë që ky aktivitet i prokurimit i inicuar nga MAP-i është në shpërputhje me LPP gjegjësisht me nenin 22 dhe nenin 24 pasi që po këtë aktivitet të prokurimit e ka udhëhequr AQP-ja dhe gjitha procedurat e inicimit për këtë aktivitet kanë kaluar nëpërmejt ZKA-së të autoritetit përkatës. Ky aktivitet i prokurimit është në fazen e rivlersimit të ofertave me vendim të OSHP-së nr. 411/16,413/16,416/16 dhe 417/17 në po këtë aktivitet të prokurimit .Ky aktivitet i prokurimit ka qenë i vendosur në LOT 10 të udhëhequr nga AQP-ja. Vlersojm që një aktivitet i prokurimit nuk mund të udhëhiqet në të njëjten kohë nga dy Autoritete Kontraktuese. Ne si OE kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pran AK-MAP dhe AK-MAP nuk e ka pezulluar këtë aktivitet të prokurimit madje as nuk ka marrë vendim për kërkesen tonë vetëm se është arsyetuar fillimisht në në e-mail që e ka marr lejen nga AQP për ta udhëhequr këtë aktivitet të prokurimit dhe pastaj me 20.01.2017 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim pa e bërë pezullimin.Me këtë rast është shkelur neni 111 i LPP-së.Kërkojmë nga OSHP që të aprovohet ankesa yne dhe të anulohet njoftimi për kontratë nga MAP deri sa AQP të merrë nje vendim për këtë aktivitet të prokurimit i cili është në ri-vlersim me vendim të OSHP-së nr 411/16,413/16,416/16 dhe 417/16.**
Provë:
1. vendimi i OSHP-së 411/16,413/16,416/16,417/16

2.Interpretimi i KRPP-së datë 18.01.2017

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Konsiderojm që dëmet materiale mund të jenë të mëdha ,ngase Kompania Laguna ka ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit të udhëhequr nga AQP-ja dhe kemi synim marrjen e kontratës pasi që oferta e jonë vlersojmë që është e përgjegjshme.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRY OF PUBLIC ADMINISTRATION
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE
DALESE
Nr.Dok.No. 292
Data/Datum/Date 20.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike/Ministry of Public Administration/Ministarstvo Javne Uprave
Zyra e Prokurimit/Kancelarije Nabavke/Office of Procurement

DATË/A:	20/01/2017
REFERENCË:	MAP/ZP/ 002
PËR/ZA/TO:	OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë
CC:	z. Arton Berisha – Sekretar i Përgjithshëm në MAP
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivit
NGA/OD/FROM:	z. Artan Fejza - Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit-MAP
TEMA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	**Kërkesë për shqyrtimi -ankesës**

Ministria e Administratës Publik ,duke vendosur sipas ankesës së OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë, me nr. të protokollit 197/17 të datës 18/01/2017 lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, kundër Njoftimin për Kontratë të AK-së të datën 11.01.2017 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, nxjerr këtë:

V E N D I M

MBI REFUZIMIN E KËRKESË PËR SHQYRTIMI -ANKESËS SË PARASHTRUAR nga **OE "LAGUNA sh.p.k"- Prishtinë**, me numër të protokollit 197/17, të datës 18.01.2017, SI TË PA BAZUAR

OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë, si pale e pakënaqur ka parashtruar ankese tek AK me datën 11.01.2017 me nr. të protokollit 197/17 kundër Njoftimin për Kontratë të AK-së, **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të LPP-së, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068,:

PRETENDIMET ANKIMORE

OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë, si pale e pakënaqur ka parashtruar ankese për rishqyrtim tek AK me datën 18.01.2017 me nr. te protokollit 197/17 kundër Njoftimin për Kontratë për **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068, siç janë:

Neni 22 dhe
Neni 24
Kompania Laguna sh.p.k. është e interesuar që të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit të inicuar nga Ministria e Administratë Publike me numer të prokurimit: 202-16-317-221 , me numer të brendshëm: 202-17-002-221 dhe me titull: Mirëmbajtja higjenike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësis. **Ne vlerësomë që ky aktivitet i prokurimit i inicuar nga MAP-i është në shpërputhje me LPP gjegjësisht me nenin 22 dhe nenin 24 pasi që po këtë aktivitet të prokurimit e ka udhëhequr AQP-ja dhe gjitha procedurat e inicimit për këtë aktivitet kanë kaluar nëpërmejt ZKA-së të autoritetit përkatës. Ky aktivitet i prokurimit është në fazen e rivlersimit të ofertave me vendim të OSHP-së nr. 411/16,413/16,416/16 dhe 417/17 në po këtë aktivitet të prokurimit .Ky aktivitet i prokurimit ka qenë i vendosur në LOT 10 të udhëhequr nga AQP-ja.. Vlersojm që një aktivitet i prokurimit nuk mund të udhëhiqet në të njëjten kohë nga dy Autoritete Kontraktuese.**

Provë:
1. vendimi i OSHP-së 411/16,413/16,416/16,417/16
2.Interpretimi i KRPP-së datë 18.01.2017

Ministria e Administratës Publike-ZP pas pranimit të ankesës ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.
Në zbatim të, Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068 nxjerrë këtë përfundim:

DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë, si pale e pakënaqur, në pretendimet e tij ankimore kundër Njoftimin për Kontratë të AK-së të datën 11.01.2017 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, për aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, KËRKESA PËR SHQYRTIM - ANKESA i refuzohet si e PA BAZUARA.

I. Detale dhe argumente për pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoritetin Kontraktues –Ministria e Administratës Publik, ka vepruar në harmoni

të plot me LPP-në, Autoritetin Kontraktues -Ministria e Administratës Publik, me datë 30/12/2016 përmes postes elektronike nga AQP- ka pranuar e-mailin për inicimin e këtij aktiviteti të prokurimit citoj "Te nderuar, AQP ka pranuar vendimin e OSHP-së ku për LOT 1 dhe 10 kemi rivlerësim, AQP ju rekomandon qe ju mundeni te beni një aktivitet te prokurimit por jo me shumë se 12 muaj".

II. Autoritetin Kontraktues -Ministria e Administratës Publike, si përgjegjëse për mirëmbajtje hixheno-teknike të objektet Qeveritare në këtë trastë edhe për Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë, në harmoni me rekomandimin e AQP-së, dhe në harmoni të plotë me LPP-në ka iniciuar AP-në në fjalë.

Konkluzion:

I. Refuzohet kërkesa për rishqyrtim-ankesa e OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë, si e pa bazuar, kundër Njoftimin për Kontratë të publikuar me datën 11.01.2017 për projektin **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221,

II. Mbetet në fuqi Njoftimin për Kontratë i AK-së - Ministria e Administratës Publike lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit te Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, të publikuar me datën 11.01.2017

- AK, vazhdon tutje me aktivitetit e prokurimit **"Mirëmbajtja higjienike në Kompleksin e Pallatit të Drejtësisë"** numër të prokurimit MAP- 202 /17/002/221, Autoriteti Kontraktues nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.
- **Këshille juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. 1 x 1 OE "LAGUNA sh.p.k "- Prishtinë
2. 1 x 1 Arkivit të MAP-it